REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 06/25
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 09.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
# PËR THEMELIM TË KOMISIONIT

1. Themelohet komisioni për shpalljen e sportistit të vitit 2024 në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
   1.1 **Burim Rexhepi –** kryesues i komisionit
   1.2 **Xhevrije Rama,** anëtare
   1.3 **Bashkim Sadiku,** anëtar
   1.4 **Lavdim Feka,** anëtar
   1.5 **Arlind Rashica,** anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përzgjedh sportistin/ten më meritor/re për të u shpallë sportist/te të vitit 2024. Përzgjedhja e sportistit/tes të vitit të bëhet, konform Rregullores komunale në fuqi për Dhënien e Dekoratave. Shpallja sportistit/tes së vitit do të konstatohet me procesverbal nga komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

<u>Vendimi iu dërgohet</u>:
- DKRS
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 09/25
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 13.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4 pika 6 dhe neni 21 i Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore nenin 43 paragrafi 14 dhe neni 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, nenin 22 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024, me propozim të Drejtorisë për Arsim dt. 10 janar 2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësim të pasurisë jo financiare - inventarit në institucionet publike arsimore të komunës.

2. Në përbërje të komisionit caktohen:
   **2.1 znj. Majlinda Bajrami,** kryesuese e komisionit
   **2.2 znj. Etjona Dragusha Sadiku,** anëtare
   **2.3 z. Luan Basholli,** anëtar

3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëj vlerësimin e inventarit në institucionet publike të arsimit në Komunën e Vushtrrisë i cili është jashtë përdorimit. Vlerësimi të bëhet konform Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024 (neni 22). Komisioni gjatë punës së tij do të bazohet në raportin e komisionit për inventarizim dt. 31.12.2022 në të cilin janë paraqitë të dhënat për inventarin i cili është jashtë përdorimit dhe i cili duhet të vlerësohet/zhvlerësohet. Raporti (në exel) i Komisionit për inventarizim është i bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi ndërsa raportet e detajuara janë në Drejtorinë për Arsim.

4. Komisioni do të filloj me pune menjëherë dhe do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës me rekomandimet për tjetërsim të inventarit të vlerësuar/zhvlerësuar.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
II
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVO

**Ferit Idrizi**

**Kryetar i Komunës**

<u>Vendimi iu dërgohet:</u>
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 10/25
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 13. 01. 2025
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4 pika 6 dhe neni 21 i Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore si dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe neni 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, nenin 22 të Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024, me propozim të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dt. 10 janar 2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
# PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Themelohet komisioni për vlerësim të pasurisë jo financiare - inventarit që është jashtë përdorimit në administratën e komunës.

2. Në përbërje të komisionit caktohen:
   **2.1 z. Bajram Beqiri,** kryesues i komisionit
   **2.2 z. Sabri Dallku,** anëtar
   **2.3 z. Ferki Rama,** anëtar

3. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëj vlerësimin e inventarit në administratën e Komunës i cili është jashtë përdorimit. Vlerësimi të bëhet konform Rregullores së MF nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullës për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare të Komunës 02Nr. 1546/24 datë 20.09.2024 (neni 22). Komisioni gjatë punës së tij do të bazohet në raportin e komisionit për inventarizim, dt. 30.12.2024 në të cilin janë paraqitë të dhënat për inventarin i cili është jashtë përdorimit dhe i cili duhet të vlerësohet/zhvlerësohet. Raporti i Komisionit për inventarizim është i bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

4. Komisioni, duhet të filloj me punë menjëherë dhe do të hartoj raport me shkrim për kryetarin e Komunës me rekomandimet për tjetërsim të inventarit të vlerësuar/zhvlerësuar.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E VUSHTRRISË • OPŠTINA VUČITRN • REPUBLIKA KOSOVO

**Ferit Idrizi**
**Kryetar i Komunës**

Vendimi iu dërgohet:
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 11/25
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 13.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 paragrafi 1 pika 14 dhe nenit 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dt. 10.01.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M
## PER FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave – aplikacioneve për subvencionim të fermerëve për: dele, dhi dhe buallica, në këtë përbërje:
   **1.1 Tefik Maloku**, kryesues i komisionit,
   **1.2 Rabije Zahiti,** anëtare
   **1.3 Ragbete Krasniqi**, anëtare

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj, vlerësoj dhe përzgjedhë përfituesit më meritor bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Komisioni për punën e tij do të mbaj procesverbal.

3. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e realizimit të këtij projekti.

4. Komuna, brenda afatit të caktuar ligjorë do të lidhë kontratë me përfituesit e subvencionit.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN - REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorit për EBPZHR
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 12/25
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 13.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 paragrafi 1 pika 14 dhe nenit 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dt. 10.01.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**PER FORMIM TË KOMISIONIT**

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave – aplikacioneve për subvencionim të bletarëve me bletë, në këtë përbërje:

   **1.1 Avdyl Feka**, kryesues i komisionit,
   **1.2 Agim Miftari**, anëtar,
   **1.3 Boban Ristic,** anëtar

2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj vlerësoj dhe përzgjedhë përfituesit më meritor bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuar në thirrjen publike. Komisioni për punën e tij do të mbaj procesverbal.

3. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e implementimit të këtij projekti.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VUSHTRRISË OPŠTINA VUČITRN REPUBLIKA KOSOVO II

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorit për EBPZHR
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit